



## KOMUNA E PRISHTINËS

### RAPORT MUJOR

Drejtoria	<b>Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit</b>
Periudha raportuese	<b>Mars 2017</b>
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Valbona Shujaku dhe Drita Rudi

#### **1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes / ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.**

Gjatë muajit raportues janë realizuar shumë takime të planifikuara dhe të paplanifikuara me partnerë, palë të jashtme dhe kolegë nga drejtoria dhe Komuna. Drejtoria e Kulturës dhe institucionet varëse, kanë realizuar planin operativ të punës, si dhe angazhime të tjera sipas nevojës.

#### **2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA**

Sektori i Kulturës:

- Realizimi i planit të veprimit për vitin 2017;
- Pranimi, shqyrtimi dhe përfundimi i lëndëve ditore;
- Takime me UNDP dhe APPDEC rreth projektit “Transparenca në kulturë”;
- Regjistrimi i lëndëve për subvencionim;
- Përpilimi i tenderëve për projektet “Manifestime dhe organizime kulture, rinore dhe sportive” dhe “Art në hapësira publike”;
- Caktimi i anëtarëve të komisioneve për shqyrtimin e kërkesave për subvencionim;
- Përpilimi i listave dhe projekteve për shqyrtim nga komisioni;
- Fillimi i punës së komisioneve;
- Puna në përpilimin e Rregullores për shqyrtimin e kërkesave për subvencionim;
- Shënimi i Ditës së Pranverës, më 21 mars.

Arkivi i qytetit:

- Punët e rregullta;
- Vazhdimi i mbajtjes së kontaktit me Konsullatën e Kosovës në Stamboll, lidhur me bashkëpunimin me Arkivin e Perandorisë Osmane në Stamboll, Turqi.

Biblioteka "Hivzi Sulejmani":

- Aktivitete të përjavshme në bashkëpunim me Këndin Amerikan në degën "Përkujtimore";
- Aktivitete me fëmijë: komentim i librit, vizatime, punë dore në degën "Përrallat".

Teatri i qytetit të Prishtinës "Dodona":

- Realizimi i aktiviteteve të rregullta në skenën e kukullave dhe shfaqje për të rritur;
- Provat e rregullta për shfaqjet e Teatrit të kukullave;
- Planifikim i një shfaqjeje në skenën për të rritur;
- Programet mysafire, sipas kërkesës.

Qendra Kulturore e Fëmijëve:

- Realizimi i programit për nder të 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas, nga Klubi i Ambasadorëve të Rinj;
- Mbajtja e takimeve të rregullta me fëmijët në të gjithë sektorët;
- Sektori i sportit, realizimi i turnirit të pingpongut për Ditë e Pranverës.

**3. *AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.***

Sektori i Kulturës:

- Realizimi i planit të veprimit për vitin 2017;
- Pranimi, shqyrtimi dhe përfundimi i lëndëve ditore;
- Takime me UNDP dhe APPDEC rreth projektit "Transparenca në kulturë";
- Përpilimi i tenderëve për projektet "Manifestime dhe organizime kulturore, rinore dhe sportive" dhe "Art në hapësira publike" dhe dorëzimi i tyre në Zyrën e prokurimit;
- Caktimi i anëtarëve të komisioneve për shqyrtimin e kërkesave për subvencionim;
- Përpilimi i listave përfundimtare dhe përgatitja e dosjeve për shqyrtim nga Komisioni;
- Fillimi i punës së komisioneve;
- Puna në përpilimin e rregullores për shqyrtimin e kërkesave për subvencionim;
- Kontrollimi i raporteve narrative dhe financiare për projektet e subvencionuara;
- Takimi me përfaqësuesit e kompanisë APPDEC, të angazhuar nga UNDP për realizimin e platformës digjitale për aplikim për subvencione;

- Shënimi i Ditës së Pranverës, më 21 mars, me pjesëmarrje të rinjve të Qendrës rinore, të cilët mbollën lule dhe fidanë ne lokacionet Parku i qytetit, në shkollën “Naim Frashëri” dhe në sheshin “Nëna Terezë”. Në programin artistik të aktivitetit interpretuan ansambli “Prishtina Brass”, SHKA “Bajram Curri” dhe kitaristët nga shkolla “Prenk Jakova”;
- Monitorimi dhe pjesëmarrje në projektet e subvencionuara “Arinjtë bashkojnë njerëzit”, promovimin e Monografisë së Shyqri Nimanit, promovimi e librit “Borite e Apokalipsit” të autorit Gani Mehmetaj, promovimin e librit “Xarnaveli” të autorit Shaban Arifaj.

#### Arkivi i qytetit:

- Puna sipas planit të punës në rregullimin e materialit arkivor, fondi: Avokatura Publike. Janë dhënë përgjigje në 45 kërkesa të palëve lidhur me dokumentacionin e kërkuar nga ana e tyre.

#### Biblioteka “ Hivzi Sulejmani”:

- Gjatë muajit mars ka vazhduar interesimi për anëtarësim dhe lexim, sidomos i të rriturve, përkatësisht studentëve;
- Anëtarë të regjistruar për muajin mars janë gjithsej 1216;
- Aktivitete të planifikuara:  
Mbajtja e orës letrare me nxënësit e shkollave të qytetit, në bashkëpunim me Karvanin e Shkrimtarëve për Fëmijë “Agim Deva”.  
Më 7 mars 2017, në orën 13:00, aktiviteti nuk është realizua. Në vend të këtij aktivitetit, pa planifikuar, u mbajt mbledhje përkujtuese për shkrimtarin Arif Demolli, me rastin e vdekjes së tij, në orën 11:00, në bashkëpunim me Karvanin e Shkrimtarëve për Fëmijë “Agim Deva” dhe Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- Dita Botërore e Leximit me Zë të Lartë, është një ditë ndërgjegjësimi që evokon për shkrim-lexim, si një e drejtë që u përket të gjithë njerëzve dhe festohet në gjithë botën, çdo vit, të mërkurën e parë të muajit mars. Edhe në “Bibliotekën Përkujtimore” kjo ditë u shënuar me shumë kënaqësi nga lexuesit e saj.  
Mësimdhënësja nga shkolla fillore “Gjergj Fishta”, znj. Maliqe Syla, zgjedh ambientin e “Bibliotekës Përkujtimore” për të shënuar Ditën Botërore të Leximit me Zë të Lartë. Pasi fëmijët lexuan librat e tyre të preferuar, në vazhdim të këtij aktiviteti u zhvillua biseda për tregimin e lexuar, ku kemi biseduar për veprimet e mira dhe jo të mira të personazheve në tregim. Ndërsa vajzat e grupit letrar lexuan esetë e shkruar nga vetë ato. Disa lexime janë përcjellë me tingujt e bukur të pianos. Ato krijuan ambient të mrekullueshëm me leximet e tyre. Aktivitetin e leximit e përmbyllëm me urimin që të kemi sa më shumë lexime nga fëmijët.
- Në Ditën Botërore të Poezisë, më 21 mars, lexuesit e “Bibliotekës Përkujtimore” patën mundësi t’i shohin aktivitetet që janë planifikuar të realizohen në Bibliotekën e Këndit Amerikan nga studentët vullnetarë. Vlen të ceket aktiviteti i

shkrimit të poezive nga vetë fëmijët. Ata shprehën dëshirën edhe t'i lexojnë poezitë e tyre. Aktiviteti përfundoi me një fotografi të të gjithë pjesëmarrësve.

Teatri i qytetit të Prishtinës "Dodona":

- Dy shfaqje për fëmijë, me gjithsej 4 repriza (jepen 2 repriza në një ditë):
  - o "Fustani pika-pika" 2 repriza,
  - o "Topi Hopi" 2 repriza.
- Dy shfaqje në terren, si mysafire:
  - o "Mustaqoshi Larosh", për nder të Ditës së Mësuesit, në Malishevë.
  - o "Prehri i gjyshit", për nderë të Ditës së Gruas, në Viti.
- Tri shfaqje me 4 repriza në skenën për të rritur:
  - o "Lojë e pafund", 2 repriza,
  - o "Muhamed Ali" 1 reprizë,
  - o "Sapotlem", 1 reprizë.
- Është realizuar shfaqja "Hisja", prodhim i organizatës "Artpolis", me temë "Trashëgimia", për nderë të Ditës së Mësuesit.

Qendra Kulturore e Fëmijëve:

- Sektori i Klubit të Ambasadorëve të Rinj, realizimi i programit dhe performancës për nderë të 8 Marsit, Ditës së Gruas. Përgatitja e mbi 350 çantave të vogla, të cilat përbrenda kanë përmbajtur nga një urim dhe mesazh simbolik drejtuar nënave dhe të gjitha grave të kryeqytetit. Çantat kanë qenë të vogla dhe të gjitha ishin punim dore, të përgatitura nga anëtarët e Klubit të Ambasadorëve të Rinj enkas për këtë festë. Të gjitha këto çanta me urime dhe mesazhe, u dhuruan nga vetë anëtarët e Klubit, nënave dhe grave (të cilat patën fatin dhe mundësinë që ta marrin njërën nga to), gjatë periudhës kohore nga 16:00 -18:00 në sheshin "Zahir Pajazaiti";
- Mbajtja e takimeve të rregullta me fëmijët në të gjithë sektorët;
- Sektori i sportit, realizimi i Turnirit të pingpongut për Ditën e Pranverës.

***AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.***

Sektori i Kulturës

- Realizimi i planit të veprimit për vitin 2017;
- Pranimi, shqyrtimi dhe përfundimi i lëndëve ditore;
- Puna grupe për përpilimin e rregullores për shqyrtim subvencioneve;
- Takime me APPDEC për realizimin e platformës digjitale;
- Kontrollimi i raporteve të projekteve të subvencionuara;

- Fillimi i punës së Komisionit për mbështetje dhe festivale dhe Komisionit për manifestime, organizime, muzikë dhe ekspozita.
- Shqyrtimi i kërkesave për dhënie të pëlqimeve për shfrytëzim të hapësirës;
- Përpilimi i projekt tenderëve për renovimin e objekteve të trashëgimisë kulturore, si dhe projektin për pajisjen e institucioneve vartëse me pajisje dhe material higjienik.

#### Arkivi i qytetit:

- Gjatë muajit mars janë zhvilluar disa biseda telefonike me Konsullatën e Kosovës në Stamboll, me konsullin z. Rrahim Morina, lidhur me bashkëpunimin e Arkivit të Perandorisë Osmane dhe Arkivit Komunal të Prishtinës;
- Takim me drejtorin e kulturës z. Besart Vllahinja dhe konsullin e përgjithshëm z. Rrahim Morina.

#### Biblioteka “ Hivzi Sulejmani”:

- Ka vazhduar realizimi i projektit ndërkombëtar me pjesëmarrjen e 25 fëmijëve dhe të rinjve sipas fushave të përcaktuara: regji, kurse në gjuhën angleze etj., më 3, 10, 17, 24 dhe 31 mars 2017.

#### Teatri i qytetit të Prishtinës “Dodona”:

- Përgatitjet për shënimin e Ditës Botërore të Teatrit, më 27 mars;
- Provat e rregullta për premierën “Anonimi i Vendeikut”, premiera më 27 mars;
- Provat e rregullta për shfaqjet e Teatrit të kukullave;
- Përgatitjet për realizimi e shfaqjes së kukullave “Kësulëkuqja” nga Qendra e Fëmijëve e Lezhës, më 18 mars 2017, ora 12:00 dhe 13:00;
- Përgatitje për realizimin e shfaqjes për nder të Ditës Botërorë të Teatrit të Kukullave, më 21 mars, ora 12:00;
- Përgatitja për realizimin programit për fëmijët me Sindrom Down, më 21 mars, ora 17:30;
- Përgatitjet për realizimin e programit të organizatës “Artpolis”, më 22 mars, ora 19:30.
- 

#### Qendra Kulturore e Fëmijëve:

- Përgatitja për pjesëmarrje në Festivalin Ndërkombëtar në Izmir;
- Mbajtja e takimeve të rregullta me të gjithë sektorët brenda QKF-së;
- Sektori i muzikës, përgatitjet intensive për koncertin e rregullt të korit dhe solistëve.

### 4.1.3 Takimet me palë

- DK-ja në vazhdimësi ka takime me qytetarë, për t'u interesuar rreth kërkesave për subvencione dhe për t'u pajisur me pëlqime për mbajtjen e aktiviteteve.

#### *4. Takimet me institucione të tjera*

#### *5. Diskutime publike / takimet me qytetarë*

##### *6.1.1 Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare*

##### *5.1.2. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër.*

- Pranimi i kërkesave për drejtori, adresimi i tyre si dhe mbajtja e evidencës në librin e protokollit të shkurtër.

#### *6. Takime të tjera*

#### *7. SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda Drejtorisë, Komunës, apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.*

#### *8. REKOMANDIME - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni, dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shtesë etj.*

#### Teatri Dodona:

- Nevojë për organizimin e trajnimeve për mbrojtje nga zjarri për rojet dhe kujdestarët e ditës;
- Servisimi i aparateve për mbrojtje nga zjarri.

#### **9. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES - Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues.**

#### Sektori i Kulturës:

- Realizimi i planit të veprimit për vitin 2017;
- Pranimi, shqyrtimi dhe përfundimi i lëndëve ditore;
- Kontrollimi i raporteve të projekteve të subvencionuara;
- Takime me UNDP dhe APPDEC rreth projektit "Transparenca në kulturë";
- Përpilimi i tenderëve për projektet "Renovimi i objekteve të trashëgimisë kulturore" dhe projekti për pajisjen e institucioneve vartëse me pajisje dhe material higjienik;
- Caktimi i anëtarëve të komisioneve për shqyrtimin e kërkesave për subvencionim, botim dhe film, teatër;
- Përpilimi i listave dhe projekteve për shqyrtim nga 2 komisionet;

- Fillimi i punës së komisioneve;
- Vazhdimi i punës së Komisionit për mbështetje dhe festivale, dhe Komisionit për manifestime, organizime, muzikë dhe ekspozita;
- Puna në përpilimin e rregullores për shqyrtimin e kërkesave për subvencionim;
- Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Librit, 2 dhe 22 prill;
- Shqyrtimi i kërkesave për dhënie të pëlqimeve për shfrytëzim të hapësirës;
- Shënimi i Ditës së Dëshmorëve të Prishtinës, më 18 prill;
- Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Tokës.

#### Arkivi i qytetit:

- Realizimi i një vizite pune në Stamboll me Konsullin e Kosovës, z. Rrahim Morina, dhe përfaqësuesit e Arkivit në Stamboll.

#### Biblioteka “ Hivzi Sulejmani”:

- Në Bibliotekën Përkujtimore, me 22 prill do të shënohet Dita Ndërkombëtare e Tokës;
- Festimi i 23 prillit Ditës botërore të librit dhe të drejtave të autorit”.

#### Teatri i Qytetit të Prishtinës “Dodona”

- Realizimi i aktiviteteve të rregullta në skenën e kukullave dhe shfaqje për të rritur;
- Planifikimi i një shfaqjeje me 2 repriza në skenën e Teatrit të kukullave;
- Provat e rregullta për shfaqjet e Teatrit të kukullave;
- Planifikimi i një shfaqjeje mysafire “Kësulëkuqja” nga Lezha, në skenën e Teatrit të kukullave, me 18 mars;
- Planifikimi i një shfaqjeje “Libri shumëngjyrësh” për nderë të Ditës Botërore të Teatrove të Kukullave, më 21 mars 2017;
- Shënimi i Ditës Botërore të Teatrit, më 27 mars 2017;
- Konferencë për medie, do të mbahet në ora 11:00, ku ITI sesioni nga Kosova, me përfaqësues Mentor Zymberaj, ku do të lexohet mesazhi, do të ndahen mirënjohje, ndërsa në ora 19:30 do të jepet premiera “Amelia e Venedikut”, regjimore: Drita Begolli, aktorë: Mentor Zymberaj dhe Gjejlane Tërbunja.

#### Qendra Kulturore e Fëmijëve:

- Pjesëmarrja në Festivalin Ndërkombëtar të valleve për fëmijë në Seferihisar - Izmir - Turqi;
- Realizimi i koncertit për fëmijë nga Sektori i muzikës;
- Në muajin prill bëhet përzgjedhja e 4 shahistëve (dy djem dhe dy vajza) fëmijë të Qendrës Kulturore të Fëmijëve të Prishtinës, në bashkëpunim me Federatën e

Shahut të Kosovës për të përfaqësuar Prishtinën sa me mirë në “Olimpiadën Ballkanike - Durrësi 2017 ”.

*TË TJERA - Shënoni çështje të tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.*

Qendra Kulturore e Fëmijëve

- Prezantimi, për herë të parë, Badmintonin nga Sektori i sportit.